



R. PROT. 408
DATE 03.07.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN

Nr. 4116/1 Prot.

Tiranë, më 02.07.2024

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë

QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Adresa: Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË" (CIT) ✓

Adresa: Rr. "Xhanfize Keko", Nr.12, (Porcelan, Kompleksi "Xhura"), Tiranë

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin nr.320, datë 27.06.2024 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, "Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në "Auditim Trafiku të Mjeteve Lëvizëse të Transportit", në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë"(CIT)".

Duke ju falënderuar,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4116/1 Prot.

Tiranë, më 27.6. 2024

URDHËR

Nr. 320, Datë 27.6. 2024

PËR
HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË
“AUDITIM TRAFIKU TË MJETEVE LËVIZËSE TË TRANSPORTIT”, NË
KOLEGJIN UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”
(CIT)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 81, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe shkronjës “g”, të pikës 2, të urdhrit nr. 113, datë 26.03.2024, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në “Auditim Trafiku të Mjeteve Lëvizëse të Transportit”, që realizohet me 26 kredite, me kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) javë, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kod SFV 0716 S. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet certifikatë e programit të studimit të formimit të vazhduar në “Auditim Trafiku të Mjeteve Lëvizëse të Transportit”, në Departamentin e Inxhinierisë Elektronike dhe Telekomunikacionit, në Fakultetin e Inxhinierisë, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT).
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të formimit të vazhduar “Auditim Trafiku të Mjeteve Lëvizëse të Transportit”, në Fakultetin e Inxhinierisë, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), fillon sipas legjislacionit në fuqi.
3. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT), të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së certifikatës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtatë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

4. Ministria e Arsimit dhe Sportit ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” (CIT).

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ANA KAPAJ

